



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Ministarstvo za Finansije, Rada i transfera – Ministry of Finance, Labor and transfers



Dogana e Kosovës – Carina Kosova – Kosovo Customs

Kodi i ri Doganor dhe i Akcizave

Kodi i ri doganor dhe i akcizave sjell disa ndryshime si në vijim:

- Siguron një kornizë gjithëpërfshirëse për rregullat dhe procedurat doganore në territorin doganor të Republikës së Kosovës, duke përshtatur zhvillimet e fundit në fushën e tregtisë dhe mjetet moderne të komunikimit, duke siguruar sistem plotësisht të automatizuar.
- Operatorët ekonomik përfitojnë plotësisht nga teknologjia e informacionit, e cila do të mundësojë reduktimin e barrës dhe shpenzimeve dhe do të përmirësojë efektivitetin e kontrolleve doganore (krijimin e balancit në mes kontrolleve dhe lehtësirave tregtare).
- Janë përcaktuar kushtet dhe procedura me të cilën autorizohen agjentët doganor, provimi profesional dhe licencimi i agjentëve doganor organizohet nga Dogana.
- Janë përcaktuar në mënyre strikte afatet ligjore për nxjerrën e vendimeve nga Dogana, çka i mundëson subjekteve siguri juridike.
- Përforon procedurat më të shpejta për operatorët ekonomik të autorizuar (AEO) me mundësi të njohjes reciproke ndërkombëtare të autorizimeve sipas parimit të proporcionalitetit.
- Autorizimi për përdorimin e një garancioni gjithëpërfshirës për të gjitha procedurat doganore.
- Ndryshime për rregullat për strehimin e përkohshëm, duke përfshirë edhe zgjatjen e periudhës së strehimit nga 20 ditë deri në 90 ditë.
- Obligimi për depozitimin e deklaratës përmbledhës për mallrat që sjellën apo dalin nga territori doganor i RKS-së.

Drejtoria e Doganës , 10.000 Prishtinë, Kosovë.
Tel & Fax (++ 381 38) 540 350 /540 836
www.dogana-ks.org

- Zhdoganimi i mallrave me autorizim të DK-së në ambientet e importuesit dhe thjeshtësimet tjera për operatorët ekonomik si zhdoganimi qëndror, evidentimi në regjistrat e deklaruesit dhe vetëvlerësimi.
- Procedurat e posaçme (PP ish PMNE) kanë pësuar ndryshime;
 - tek magazinat doganore kemi vetëm dy lloje (publike dhe private),
 - është hequr procedura nën kontroll doganor PKD, tani pjesë e PB mallrat në përpunim të brendshëm (PB), me rastin e lëshimit të mallit në qarkullim të lirë të lëndës së parë ose produktit kompensues nuk aplikohet kamata kompensuese.
- Me ligjin e akcizës përcaktohen obliguesit akcizor, lindja e obligimit të llogaritjes dhe pagesës së akcizës, në mënyre të detajuar, rregullat për autorizimin dhe shfuqizimin për magazinat akcizore, shtyrjen e pagesës, rregullat për përdoruesin e liruar i cili produktet akcizore i përdor në procesin e prodhimit me qëllim të prodhimit të një produkti jo akcizor dhe përdoruesit për shfrytëzim të burimeve të energjisë (energjentet).
- Akciza për produktet e duhanit të vendosur në magazinë doganore apo magazinën akcizore duhet të paguhet më së largu deri 120 ditë nga realizimi i importit.
- Me ligjin për kundërvajtje janë përcaktuar qartë një listë të veprimeve apo mos veprimeve që përbëjnë shkelje të rregullave doganore, lartësia e dënimeve ku për shkelje të sanksionuara duke marrë në konsideratë mënyra e kryerjes dhe shkeljet kategorizohen nisur nga fakti se a ka pasur qëllim apo neglizhencë. Secila shkelje e sanksionuar është e ndërlidhur me nenet përkatëse të ligjit material çka siguron trajtim ligjor dhe siguri juridike me rastin e marrjes së vendimeve.
- Janë zgjeruar kompetencat e oficerëve doganor në pajtim me praktikën e doganave të BE-së me qëllim të evitimit të vakumit ligjor dhe luftimit të evazionit fiskal, verifikimeve të transfereve bankare, mbledhjes së detyrueshme dhe ushtrimit të kontroleve në territorin doganor të Republikës së Kosovës.
- Për mallrat e importuara nga udhëtarët, është vendosur pragu i ri vlerës nga deri 175 € në deri në 300 € për rrugë tokësore dhe 430 € në rrugë ajrore.

Te gjitha aktet nënligjore të paraparë Kodin e ri miratohen në periudhë prej një (1) viti nga hyrja në fuqi e këtij Kodi dhe deri në miratimin e akteve nënligjore të parapara me këtë Kod, zbatohen aktet nënligjore që janë në fuqi, me kusht që nuk janë në kundërshtim me dispozitat e Kodit ri Doganor.